



## Sistemi i menaxhimit për shtëpitë botuese dhe shtypshkronjat



### ProShtyp

(Sistemi i Menaxhimit në Internet për Shtëpitë Botuese dhe Shtypshkronjat)

Ai i mundëson administrimit një kontroll dhe monitorim në të gjitha hallkat e funksionimit të tij, që nga furnizimi me lëndën e parë, e deri në shpërndarjen dhe shitjen e produkteve.

### Ku aplikohet

Mund të aplikohet shumë mirë nga shtypshkronjat apo shtëpitë botuese pavarësisht nëse ato kanë ambiente në destinacione të ndryshme për prodhimin, magazinimin, administrimin apo shitjen.

ProShtyp funksionon me të dhëna qendrore të cilat aksesohen dhe menaxhohen on line nga të gjithë sektorët dhe terminalët e përdorimit të tij. Nëpërmjet tij, në ç do kohë nga ç do terminal on line, mund të shihen të dhëna mbi shitjet, pagesat, debitorët apo gjendjen e mallrave dhe inventarin në të gjitha magazinat dhe dyqanet.

## Përshkrimi i sistemit

Sistemi përdor një bazë të dhënash qëndore në MS SQL server në të cilën ruhen të gjitha rekordet. Për të mundësuar aksesimin e bazës së të dhënave nga терминаlet në sistem është ngritur një Web Server për këtë qëllim. Të gjitha терминаlet në të cilat është instaluar programi klient komunikojnë nëpërmjet këtij Web Serveri me bazën e të dhënave. Sipas zgjedhjes терминаlet mund të jenë të lidhur në rrjet LAN ose nëpërmjet Internetit me Web Serverin. Kjo strukturë lejon që të dhënat të aksesohen njëkohësisht nga të gjithë përdoruesit e sistemit. Çdo veprim i kryer në sistem si p.sh regjistrimi i faturave të shitjes,

blerjes, lëvizjet e magazinave apo veprimet financiare do të kryhet në kohë reale në bazën e të dhënave. Në këtë mënyrë të gjithë përdoruesit në distancë do të mund të aksesojnë të dhënat e përditësuara nga çdo farëdo terminal.

### Struktura e funksionimit

Ky sistem menaxhon ciklin e plotë të subjektit nga kërkesat për porosi deri te faturimi i klientit dhe për më tepër menaxhon kartelat e klientëve apo gjithë subjekteve me të cilët ka marëdhënie financiare.

Subjekti përkatës mund të ngrejë një strukturë me disa magazina dhe disa pika shitje. Përdoruesi mund të kryejë lëvizje të mallrave nga këto magazina në mënyrë automatike. Lëvizjet nënkuptojnë dalje malli nga njëra dhe hyrje te tjetra. Për çdo magazinë ruhet inventari përkatës në sasi dhe vlerë duke përdorur metodën e kostos mesatare. Ky mund të shihet dhe të printohet nga përdoruesi në çdo moment të dëshiruar.

Lëvizjet e mallrave nga të gjitha magazinat kryhen me koston e tyre.

Për çdo pikë shitje mund të vendosen çmime të ndryshme të të njëjtit artikull. Kur kryhet një

shitje e re, artikujt për shitje mund të zgjidhen nëpërmjet skanerit me Barcode. Mund të printohen nga sistemi etiketat me barcode për çdo artikull.

Sistemi lejon aplikimin e zbritjeve në forma të ndryshme dhe për grupe klientësh të regjistruar.

## Skema e organizimit

FINANCE



ADMINISTRIM



PRODHIM



SHITJE



INTERNET




MAGAZINE



TE DHENAT



SKEMA STRUKTURE E FUNKSIONIMIT TE PROSHTYP



STRUKTURA E ORGANIZIMIT TE PROGRAMIT PROSHTYP

MARKETING	PRODHIMI	MAGAZINA	FINANCA	RAPORTIM
— Kerkese Porosie	— Urdher Prodhimi	— Furnizime	— Kliente	— Gjendje Furnizimi
— Analize Kostoje	— P V Prodhimi	— Hyrje Dalje	— Furnitore	— Gjendje Pagesa
— Oferte	— Urdher Furnizimi	— Inventar	— Distributore	— Inventar
— Flete Porosie			— Faturim	— Status Prodhimi
			— Pagesa	— Status Porosie

## Funksionet kryesore të programit

- Menaxhim i Shitjeve.
- Menaxhim i Blerjeve.
- Menaxhimi i disa magazinave për inventarin e gjendjes së artikujve në sasi dhe vlerë.
- Menaxhimi i lëvizjes së mallrave nëpër magazina.
- Menaxhimi i kërkesave për ofertë, Ofertave.
- Menaxhimi i Porosive për prodhim.
- Ndjekjen hap pas hapi të gjithë procesit të prodhimit, deri në momentin e shitjes.
- Mundësi për të krijuar paleta, gjë që lehtëson procesin e shitjes.
- Menaxhimi i përbashkët i Subjekteve, kategorizimi sipas llojit të tyre : Klientë, Furnitorë, Agjentë, Distributorë etj.
- Ç do subjekti mund ti caktohen attribute të ndryshme, si psh. një përqindje zbritje, zona shitje apo ndarje artikujsh.
- Gjenerimi i kartelave të subjektit të cilat evidentojnë në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet financiare të tyre.
- Llogari për Subjektet e regjistruar.
- Menaxhimi i disa Arkave ( Bankave). Pagesa – Arkëtime.
- Artikujt për shitje mund të zgjidhen nëpërmjet skanerit me Barcode.
- Artikujt mund të importohen nga tabela exceli.
- Mund të printohen nëpërmjet programit Bar-kodet për artikujt e nevojshëm.
- Zgjedhje e disa llojeve dhe formateve të faturës (Shirit 60mm, 80mm, A6, A4).
- Për identifikimin e klientëve mund të përdoren edhe karta magnetike ose karta me kode identifikimi.
- Nivele aksesi sipas funksioneve për përdoruesit.
- Raport kosto-fitim i shitjeve.
- Menaxhohen përdoruesit e programit sipas funksioneve të tyre (shitje, magazinë, financë, administrim etj).
- Bëhet ruajtja dhe pasqyrimi i të gjitha Shitjeve të kryera dhe atyre të anuluar.
- Raporte për çdo periudhë të zgjedhur kohore për shitjet, furnizimet, artikujt e shitur, dhe bilancin financiar.
- Printimi i të gjitha raporteve ose exportimi i tyre në Excel.

Të gjitha veprimet e kryera në sistem ruhen me emrin e përdoruesit përkatës që ka hapur

sistemin në atë moment. Sistemi ruan dhe pasqyron të gjitha shitjet si ato të kryera edhe ato të anuluar. Sistemi lejon pasqyrimin dhe printimin e aktivitetit financiar ditor dhe inventarit ditor të artikujve të shitur ç ka e bën të kontrollueshëm dhe të sigurtë aktivitetin ditor.

Sistemi lejon në ç do moment kontroll të arkave nga përdoruesi i autorizuar dhe gjithashtu kryerjen e veprimeve në arkë (derdhje apo tërheqje). Gjithashtu sistemi ofron raporte mbi shitjet, blerjet, sasinë e artikujve të shitur, dhe bilancin financiar në ç do periudhë kohore të zgjedhur nga përdoruesi si dhe ruajtjen në excel apo printimin e këtyre raporteve dhe mirëmbajta, eksportimi dhe ruajtja e të dhënave të sistemit sa herë që dëshirohet.

Të gjitha funksionet e mësipërme janë bërë të mundura të realizohen online, pa patur nevojën e një lidhjeje fizike ndërmjet terminaleve me serverin qendror.

## Dokumentat që gjenerohen nga programi

- Kërkesë Porosie
- Ofertë
- Fletë porosie
- Urdhër prodhimi
- Urdhër blerje për materiale furnizimi
- Proces Verbal i produktit të gatshëm.
- Fletë Hyrje
- Fletë Dalje
- Faturë Furnizimi
- Inventar
- Kartela e Subjektit
- Aktiviteti i Subjektit
- Faturë shitje
- Listë e faturave
- Mandat Pagese
- Mandat Arkëtimi
- Lista e pagesave

### Ç farë duhet për të patur sistemin?

Nuk është e nevojshme të keni asnjë pajisje shtesë apo të kryeni ndonjë instalim. Ajo ç farë ju duhet janë vetëm kompjutera me akses interneti. Nuk është e nevojshme kapacitet i lartë i lidhjes së internetit. Min 256 kbps.

### Sa duhet paguar për instalimin fillestar?

Në rastin kur sistemi merret në përdorim nuk është e nevojshme asnjë pagesë fillestare për aktivizimin e tij. Kompanitë do të kryejnë vetëm pagesën periodike sipas variantit përkatës.

### Sa të sigurtat janë të dhënat tuaja?

Prodokument merr përsipër sigurinë e të dhënave. Këto të fundit do të ruhen në serverat e hostimit të Prodokument të cilët janë instaluar në ambiente të sigurtat. Këto servera ofrojnë akses me kapacitet të lartë nga Interneti dhe shërbim të përhershëm në 99.9 % të kohës.

Gjithashtu pajisjet e ruajtjes janë MIRROR për garanci më të madhe. Backupi i të dhënave kryhet ç do ditë në pajisje të tjera të posaç me.

## Versionet e Sistemit

ProShtyp vjen në 2 versione dhe është përshtatur sipas funksionimit të kompanive.



ProShtyp për Shtypshkronjat vjen i plotë dhe me të gjitha modulet e nevojshme të menaxhimit.

ProShtyp për Shtëpitë botuese vjen i reduktuar dhe i personalizuar për funksionimin e

tyre. Në këtë version nuk përfshihet:

Moduli i menaxhimit të prodhimit  
Moduli i menaxhimit të Kërkesave për porosi dhe Ofertave.

Konkretisht nuk përfshihet menaxhimi për funksionet më poshtë:

- Kërkesë Porosie
- Ofertë
- Fletë porosie
- Urdhër prodhimi
- Urdhër blerje për materiale furnizimi
- Proces Verbal i produktit të gatshëm.

Ky version vjen me një Ç mim të reduktuar dhe të pranueshëm për kompaninë.